




REPUBLIKA E SHQIPËRISE
GJYKATA KUSHTETUESE

Buletini periodik i Gjykatës Kushtetuese


Vendimet maj-qershor 2024



Buletini periodik i vendimmarrjes

Nr. 3 , maj-qershor 2024

© Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë



Ky botim u mundësua me mbështetje nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Shënim: Opinonet dhe qëndrimet e paraqitura në këtë botim nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane apo të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).



HYRJE

Në kuadër të komunikimit të vazhdueshëm me publikun dhe median, të garantimit të transparencës, si dhe të rritjes së aksesit në Gjykatën Kushtetuese, si një nga parimet më të rëndësishme dhe thelbësore të administrimit të drejtësisë, Gjykata publikon Buletinin Periodik të vendimmarrjes së saj. Ai ka si qëllim informimin dhe njohjen e praktikantëve të së drejtës, studiuesve të ligjit, e çdo lexuesi, me vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese, dhe me qëndrimet e mbajtura prej saj. Kështu, botimi i sjell vendimet në mënyrë të përmbledhur dhe me një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për lexuesin. Për secilën prej tyre, paraqiten faktet që lidhen me çështjen konkrete, vlerësimi i Gjykatës lidhur me pretendimet e kërkuarit, ashtu edhe vendimmarrja e mënyra e votimit.

Në këtë numër do të gjeni të gjitha vendimet përfundimtare të dhëna gjatë periudhës maj-qershor 2024.

PËRMBAJTJA

Kontroll i akteve normative	4
Ankim kushtetues individual (vendime përfundimtare)	9

Parimi i demokracisë përfaqësuese - Parimi i autonomisë parlamentare

FJALË KYÇE

Demokracia përfaqësuese/ autonomia e Kuvendit/ shkelje disiplinore/ masë disiplinore/ përjashtimi nga pjesëmarrja në komisione dhe seanca plenare/ mandat i deputetit/ veprimtari si anëtar i Kuvendit/ Rregullore

Gjykata, në drejtim të juridiksionit të saj vlerësoi se Rregullorja, edhe pse për nga natyra e saj, është një akt *sui generis* me natyrë atipike, duke pasur parasysh se pretendimet lidhen me norma kushtetuese, duke krijuar, për rrjedhojë, mosmarrëveshje me natyrë kushtetuese, si dhe për sa kohë që ky akt nuk i nënshtrohet në mënyrë të shprehur kontrollit të asnjë juridiksioni tjetër gjyqësor dhe as nuk ka ndonjë ndalim të shprehur për ushtrimin e kontrollit kushtetues, shqyrtimi i pajtueshmërisë së dispozitave të Rregullores përfshihet në juridiksionin kushtetues.

Parimi i autonomisë parlamentare nuk është mbizotërues dhe duhet të ushtrohet në pajtim me konceptet e demokracisë efektive dhe të shtetit të së drejtës. Edhe pse Kuvendi, parimisht, ka mandatin kushtetues që të ndërhyjë për rregullimin edhe të atyre çështjeve që kanë të bëjnë me përcaktimin e sjelljeve/veprimeve që përbëjnë shkelje disiplinore, ai duhet të respektojë parimin e proporcionalitetit.

Jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (Rregullorja e Kuvendit) – vendimi nr. 48, datë 19.06.2024

Faktet

Me vendimin 126/2023, Kuvendi miratoi ndryshime në Rregulloren e tij në drejtim të masave disiplinore, më konkretisht duke zgatur deri në 30 ose 60 ditë masën disiplinore të përjashtimit nga komisionet dhe/ose seancat plenare, si dhe duke parashikuar shkeljet për të cilat jepen këto masa.

Kërkuesi iu drejtua Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) për shfuqizimin e këtyre ndryshimeve duke pretenduar se cenojnë nenin 83, pika 2, të Kushtetutës në lidhje me zbatimin e procedurës së përshpejtuar për miratimin e tyre, si edhe të drejtat e deputetëve që burojnë nga statusi i tyre kushtetues, duke çuar në pengimin e ushtrimit efektiv të mandatit kushtetues, për rrjedhojë edhe të vetë Kuvendit.

Edhe pse kërkuesi i parashitroi pretendimet në drejtim të cenimit të parimit të proporcionalitetit të ndërhyrjes në kufizimin e të drejtave të deputetit, në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës, Gjykata, bazuar në parimin *iura novit curia*, vlerësoi se ato kanë të bëjnë në thelb jo me të drejtat e deputetit si individ, por me ushtrimin e funksionit të tij si përfaqësues i popullit, pra me parimin e demokracisë përfaqësuese në kuptim të nenit 2 të Kushtetutës.

Vlerësimi i Gjykatës

Parimi i demokracisë përfaqësuese - Në rastin konkret vihet në diskutim përcaktimi i kufijve ndërmjet dy parimeve të dallueshme, që gëzojnë të njëjtën mbrojtje kushtetuese, nga njëra anë ai i autonomisë parlamentare vetërregulluese dhe, nga ana tjetër, ai i demokracisë përfaqësuese. Edhe pse Kuvendi, brenda pushtetit të tij autonom vetërregullues, ka të drejtën dhe lirinë për të zgjedhur mjetet që ai konsideron të nevojshme dhe efektive për përmbushjen e qëllimit të mirëfunksionimit të brendshëm, ai ka edhe detyrimin të respektojë parimin e proporcionalitetit, i cili nuk lejon ushtrimin e pushtetit në mënyrë të pakufizuar. Nga ana tjetër, Gjykata thekson se parimi i demokracisë përfaqësuese i garanton çdo deputeti që të ushtrojë, gjatë veprimtarisë parlamentare, të drejtat që parashikohen në nenin 70 të Kushtetutës dhe në ligjit 8550/1999. Kjo e drejtë nuk garantohej pa asnjë kufizim, por mund të kufizohet për shkak të parimeve dhe vlerave të tjera të nivelit kushtetues, siç është ai i mirëfunksionimit të Kuvendit.

Gjykata vëren se Kuvendi ka miratuar disa ndryshime dhe shtesa në dispozitat e Rregullores, me anën e të cilave parashikohen vendosje masash disiplinore me kohëzgjatje 10, 30 ose 60 ditë për shkeljet që mund të kryhen nga deputetët.

Duke konsideruar ndryshimet e Rregullores, Gjykata vlerëson se dy dispozita (shkronja “a” e pikës 6 të nenit 65/1 dhe shkronja “a” e pikës 1 të nenit 65/1) parashikojnë për të njëjtën shkelje masa disiplinore me kohëzgjatje të ndryshme. Në këtë drejtim, paqartësia e përmbajtjes së këtyre dy dispozitave, që parashikojnë masa të ndryshme, është e tillë që çon në arbitraritet në zbatimin e saj. Po kështu është edhe përmbajtja e shkronjës “b” të pikës 7 të nenit 65/1 të Rregullores, që parashikon dhënien e masës disiplinore të përjashtimit nga komisionet dhe/ose seanca plenare deri në 60 ditë “kur deputeti kryen veprime/sjellje që dyshohet se përmbajnë elemente të veprës penale, të parashikuara në Kodin Penal”. Gjykata thekson se përcaktimi i sjelljeve dhe veprimeve të deputetit që përbëjnë shkelje disiplinore duhet të bëhet në mënyrë të qartë dhe konkrete, ndërkohë që referimi, në mënyrë të përgjithshme, në veprime ose sjellje të papërcaktuara, krijon mundësi për arbitraritet gjatë zbatimit të tyre.

(vijon në faqen 5)

KONTROLL I AKTEVE NORMATIVE

Në këtë rast vlerësimi i Gjykatës nuk është një kontroll klasik si ai në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës, për sa kohë interesi dhe nevoja e ndërhyrjes janë aspekte të prezumuara, sepse Kuvendi vepron bazuar në parimin e autonomisë parlamentare. Ajo ndalet vetëm në verifikimin e ashpërsisë së masave, pra nëse ato, jo vetëm për shkak të përmbajtjes, por edhe gjatë zbatimit, mund të sjellin cenim ose kufizim në ushtrimin e mandatit përfaqësues të deputetit në zbatim të parimit të demokracisë përfaqësuese.

Edhe sa i përket përmbajtjes së shkronjës “c” të pikës 7 të nenit 65/1 të Rregullores, Gjykata vëren se parashikimi i veprimeve dhe shkeljeve që passjellin zbatimin e saj duhet të jetë i përcaktuar ose i përcaktueshëm në mënyrë të qartë dhe të saktë, duke mos lënë hapësirë për interpretimin apo zbatimin e saj në mënyrë diskrecionare, të tillë që mund të cenojë në mënyrë joproporcionale ushtrimin e mandatit përfaqësues.

Gjykata vëren, gjithashtu, se pika 9 e nenit 65/1 të Rregullores, sipas të cilës deputetit, gjatë periudhës së zbatimit të masës disiplinore, i ndalohej të kryejë dhe çdo veprimtari tjetër si anëtar i Kuvendit,” edhe përtej pjesëmarrjes së tij në seancë plenare dhe në komisione, përbën një masë të re disiplinore. Masa disiplinore e përjashtimit deri në 30 ose 60 ditë është masa më e ashpër që jepet ndaj deputetit, për rrjedhojë, çdo kufizim tjetër shoqërues i kësaj mase disiplinore përbën një kufizim joproporcional në ushtrimin e mandatit përfaqësues, pasi konsiderohet se është më e ashpër në drejtim të pasojave të saj se sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin pjesërisht të kërkesës (tetë gjyqtarë u shprehën me mendim pjesërisht kundër).



Liria e veprimtarisë ekonomike – Parimi i sigurisë juridike

FJALË KYÇE

Tatim mbi të ardhurat/ individ i vetëpunësuar/ individ tregtar/ entitete/ normë tatimore/ bazë tatimore vjetore/ të ardhura bruto/ listë analitike/ efektet e ligjit

Përmbajtja e nenit 69, pika 1, shkronja “dh”, fjalia e dytë dhe e tretë, të Ligjit të Tatimeve, që përcakton një kalendar të ndryshëm për hyrjen në fuqi të detyrimit të vetëpunësuarit që furnizojnë shërbime profesionale në krahasim me të vetëpunësuarit që kryejnë veprimtari të mirëfilltë tregtare (duke rezervuar për këta të dytët një zgjidhje të butë me hyrjen në fuqi të normës së re tatimore në vitin fiskal 2030), e gërshtuar me masën e normës së re tatimore prej 15%, mungesën e një periudhe të përshtatshme njoftimi për subjektet mbi të cilat rëndon norma e re tatimore, pa ndonjë lloj forme përshkallëzimi dhe pa udhën mundësinë e duhur subjekteve të përshtatshme me masën e re të normës tatimore cenon parimin e proporcionalitetit në drejtim të domosdoshmërisë/ ashpërsisë së mjetit të përzgjedhur nga ligjvënësi.

Jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, Shoqata “Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar”, Shoqata “Instituti i Kontabilistëve të Miratuar”, Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë (dispozitat e Ligjit të Tatimeve për hyrjen në fuqi të detyrimit tatimor për të vetëpunësuarit që furnizojnë shërbime profesionale) – vendimi nr. 52, datë 27.06.2024

Faktet

Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” (Ligji i Tatimeve), i cili, në nenin 24, pika 2, parashikon se të ardhurat neto të tatueshme nga biznesi për individët tregtarë dhe të vetëpunësuarit taten me normat progresive si vijon: për bazën tatimore vjetore 0 – 14 milionë lekë, norma tatimore është 15% dhe për bazën tatimore vjetore mbi 14 milionë lekë, norma tatimore është 23%. Sipas nenit 69, pika 1, shkronja “dh”, të Ligjit të Tatimeve, lehtësitë dhe përjashtimet tatimore të parashikuara në ligjin nr. 8438/1998 vazhdojnë të zbatohen. Gjithashtu, për individët tregtarë, të vetëpunësuarit dhe entitetet, me të ardhurat bruto deri 14 milionë lekë në vit, norma e tatimit 0% do të aplikohet deri më 31 dhjetor 2029; norma e tatimit 0% nuk aplikohet për tatimpaguesit të cilët furnizojnë shërbime profesionale; lista analitike e shërbimeve profesionale përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me legjislacionin në fuqi rregullues lidhur me këto shërbime profesionale. Ligji i Tatimeve ka hyrë në fuqi në datën 18.5.2023, pra 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, ndërsa efektet e tij fillojnë nga data 1 janar 2024. Përjashtim bëjnë parashikimet e neneve 22, 23 dhe 24, pika 1, që i fillojnë efektet nga data 1 janar 2025, shkronja “ç” e pikës 1 të nenit 69, që i fillojnë efektet me hyrjen në fuqi të Ligjit për Tatimet dhe pika 2 e nenit 69, që i fillon efektet nga data 1 qershor 2023. Në vijim, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 753/2023 (10 ditë përpara se të fillonte zbatimi i efekteve të Ligjit për Tatimet), i cili në nenin 4 ka përcaktuar listën e shërbimeve me objekt tatimi nga data 1 janar 2024, përfshirë veprimtaritë ekonomike të tatimpaguesve, persona fizikë të vetëpunësuar dhe entitete që ofrojnë shërbime profesionale, me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, të cilët do të paguajnë tatim mbi të ardhurat personale nga biznesi ose tatim mbi të ardhurat e korporatës, duke filluar nga viti fiskal 2024.

Vlerësimi i Gjykatës

Liria e veprimtarisë ekonomike e lidhur me parimin e sigurisë juridike - Gjykata konstatoi se ndryshimi dhe zbatimi i një skeme tatimore për të ardhurat e gjeneruara nga ushtrimi i veprimtarisë dhe aktivitetit deri në 14 milionë lekë në vit përbën detyrim ligjor me natyrë financiare dhe, si i tillë, ato ndërhyjnë në të drejtat dhe liritë kushtetuese të tatimpagueseve. Në këtë kuptim, Gjykata shqyrtoi nëse ndërhyrja është bërë me ligj, nëse ekziston interesi publik dhe nëse proporcionaliteti midis ndërhyrjes dhe gjendjes që e ka diktuar atë është i drejtë, pra i nevojshëm, i domosdoshëm dhe i përshtatshëm, sipas standardeve kushtetuese.

Nga analiza e të dhënave të paraqitura nga palët në proces, Gjykata konstatoi se ligjvënësi ka vendosur zbatimin e normës tatimore 15% për të ardhurat neto të tatueshme nga 0 deri në 14 milionë lekë në vit për kategorinë e biznesit për individët tregtarë dhe të vetëpunësuarit. Ndërsa ka zgjedhur zbatimin e kësaj norme ndaj të ardhurave bruto për tri kategori, të cilat janë individët tregtarë, të vetëpunësuarit dhe entitetet, duke e përshkallëzuar atë në dy periudha të ndryshme. Konkretisht, për individët tregtarë kjo normë zbatohet pas datës 31 dhjetor 2029, pasi deri në këtë datë norma e tatimit mbi të ardhurat do të jetë 0%, ndërsa për të vetëpunësuarit dhe entitetet, kjo normë tatimore do të zbatohet prej datës 1 janar 2024.

(vijon në faqen 7)

KONTROLL I AKTEVE NORMATIVE



Gjykata çmoi se përmbajtja e nenit 69, pika 1, shkronja “dh”, fjalia e dytë dhe e tretë, të Ligjit të Tatimeve, që përcakton një kalendar të ndryshëm për hyrjen në fuqi të detyrimit të ri tatimor për të vetëpunësuarit që furnizojnë shërbime profesionale në krahasim me të vetëpunësuarit që kryejnë veprimtari të mirëfilltë tregtare (për të cilët Ligji për Tatimet parashikon një hyrje në fuqi të normës së re në vitin fiskal 2030), e gërshetuar me masën e normës së re tatimore prej 15%, mungesën e një periudhe të përshtatshme njoftimi për subjektet mbi të cilat rëndon norma e re tatimore (ajo hyri në fuqi rreth 7 muaj nga miratimi i ligjit, ndërsa përcaktimi i llojit të aktiviteteve konkrete, të cilat do t'i nënshtroheshin normës të re tatimore duke filluar nga viti fiskal 2024, u miratua me vendim të Këshillit të Ministrave vetëm 10 ditë përpara se të fillonte zbatimi i efekteve të ligjit), pa ndonjë lloj forme përshkallëzimi dhe pa u dhënë mundësinë e duhur subjekteve të përshtatshin me masën e re të normës tatimore cenon parimin e proporcionalitetit në drejtim të domosdoshmërisë/ashpërsisë së mjetit të përzgjedhur nga ligjvënësi.

Zbatimi i ligjeve tatimore duhet të shoqërohet me masa të përshtatshme kalimtare, ndaj dhënia kohë tatimpaguesve u jep atyre mundësinë jo vetëm të njihen me formulat e llogaritjes së zbatimit të tatimit ndaj tyre, por edhe të marrin masa që vetë subjektet tatimpaguese i vlerësojnë të nevojshme për të përballuar pasojat e skemës së zbatueshme.

Gjykata, duke mos vënë në dyshim hapësirën e gjerë dhe diskrecionin e ligjvënësit për të përcaktuar masën e normës tatimore *per se* (rasti konkret shifra 15%) dhe as faktin se përjashtimi nga detyrimet tatimore nuk përbën të drejtë të subjektit tatimpagues, vlerëson se nga analiza e ndërthurur e rrethanave në të cilat norma e re tatimore është miratuar dhe zbatuar, ajo nuk është proporcionale në drejtim të domosdoshmërisë, ndaj pretendimi i kërkuar është i bazuar. Ndodhur në këto kushte, Gjykata çmon të mos ndalet në analizën e mëtejshme të nënkriterit të përshtatshmërisë.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin pjesërisht të kërkesës (dy gjyqtarë u shprehën me mendim paralel dhe pjesërisht kundër, dy gjyqtarë me mendim pjesërisht kundër dhe dy gjyqtarë me mendim kundër).



E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

FJALË KYÇE

Person i mitur/ pagesë e aftësisë së kufizuar me kujdestar/ KMCAP/ interesi i fëmijës së mitur për të gëzuar jetë cilësore të shëndetshme/ rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuesja

Çështja e kërkueses lidhet me interesa “vetjakë e jetësorë”, ku përfshihen edhe interesat e fëmijës së saj të mitur, e cila është me aftësi ndryshe, kërkon nga gjykatat shqyrtimin me përparësi të çështjes, veçanërisht kur objekti i mosmarrëveshjes ka të bëjë me pretendime financiare. Interesi i fëmijës së mitur për të gëzuar jetë cilësore të shëndetshme përbën prioritet parësor për çdo institucion, veçanërisht për autoritetet vendimmarrëse me ndikim të drejtpërdrejtë në përkujdesjen dhe mirëqenien e tyre.

Bardhoke Bicaku (kohëzgjatja e paarsyeshme e procesit gjyqësor në gjykatën administrative të apelit) – vendimi nr. 37, datë 07.05.2024

Faktet

Kërkuesja është nëna e një vajze trevjeçare që është diagnostikuar me diagnozën “paraplegji” dhe për këtë arsye Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) e trajtoi me statusin e paraplegjikut. Edhe kur u rikomisionua nga KMCAP-i Niveli i Parë, vajza u trajtua me të njëjtin status. Vendim i këtij të fundit u ndryshua më pas nga KMCAP-i Epror, i cili vendosi të mos i njihje vajzës më statusin e paraplegjikut, por vetëm të drejtën të përfitonte pagesën e aftësisë së kufizuar. Kërkuesja nuk ishte dakord me këtë ndryshim, pasi ky ndryshim e përkeqësonte situatën e vajzës së mitur, prandaj iu drejtua gjykatës. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë e rrëzoi padinë. Kërkuesja u ankua dhe çështja u regjistrua në Gjykatën Administrative të Apelit në 19.1.2022, dhe ende nuk është shqyrtuar. Për të përshpejtuar gjykimin, kërkuesja i bëri kërkesë Gjykatës Administrative të Apelit, e cila e rrëzoi kërkesën. Gjykata e Lartë gjithashtu e rrëzoi rrekursin.

Kërkuesja iu drejtua Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim individual për shfuqizimin e këtij vendimi për shkelje të afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit.

Vlerësimi i Gjykatës

Shqyrtimi i çështjes brenda një afati të arsyeshëm – Në lidhje me *sjelljen e kërkueses*, ajo nuk është bërë shkak për tejzgjatjen e gjykimit të çështjes së saj kurse për sa i takon *kompleksitetit të çështjes*, ajo nuk paraqitet komplekse pasi ka të bëjë me shpërblimin e dëmit pasuror e moral, si dhe shpenzimet e nevojshme si pasojë e dëmit të shkaktuar nga mjekimi i pakujdesshëm.

Për sa i përket *sjelljes së autoriteteve*, vonesa në gjykimin e çështjes është pasojë e ngarkesës së lartë në atë gjykatë dhe e gjyqtarit relator, shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi.

Në lidhje me *rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi*, pas kryerjes së vizitës dhe vlerësimit të dokumentacionit mjekësor, si dhe ekzaminimeve përkatëse, KMCAP-ja Epror ka vendosur që vajza e kërkueses nuk përfiton statusin e paraplegjikut, por kalon si përfituese e pagesës së aftësisë së kufizuar, grupi i parë me kujdestar. Gjykata vlerëson se çështja e kërkueses, për shkak të natyrës së saj, e cila lidhet me interesa “vetjakë e jetësorë”, ku përfshihen edhe interesat e fëmijës së saj të mitur me aftësi ndryshe, kërkon nga gjykatat të shqyrtojnë me përparësi çështjen. Gjykata e Lartë e ka analizuar çështjen vetëm në drejtim të kompleksitetit të saj dhe jo të rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkuesja. Gjykata e Lartë duhet të mbante në konsideratë faktin se pretendimet me natyrë financiare të kërkueses kanë për qëllim mbulimin e shpenzimeve për sëmundjen dhe trajtimin e vajzës së saj të mitur.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e kërkesës, konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes dhe detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit të gjykojë çështjen brenda një afati 6-mujor.

E drejta e aksesit - Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor - E drejta për t'u rehabilituar dhe/ose zhdëmtuar

FJALË KYÇE

Marrëdhënie pune me afat të pacaktuar/ statusi i nëpunësit civil/ Kodi i Punës/ dëmshpërblim/ ndryshimi kryesisht i objektit dhe shkakut ligjor të padisë

Pretendimi kushtetues ka të bëjë me mënyrën se si Gjykata e Lartë ka interpretuar konceptet ligjore procedurale të objektit dhe shkakut ligjor të padisë. Për rrjedhojë, ajo ka vepruar brenda funksionit kushtetues për interpretimin e ligjit duke i dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të rekursit.

Kërkuesi Adem Rrenga (interpretimi i koncepteve ligjore procedurale të objektit dhe shkakut ligjor të padisë) - vendim nr. 38, datë 14.05.2024

Faktet

Kërkuesi, i cili kishte pozicionin e drejtorit në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara është liruar në mënyrë të menjëhershme nga detyra me urdhër të ministrit të Financave. Pas ankimit administrativ, kërkuesi paraqiti padi me objekt shfuqizimin e urdhrit për lirimin nga detyra, rikthimin në punë dhe shpërblim për kohën e qëndrimit pa punë sipas ligjit nr. 152/2013 “Për statusin e nëpunësit civil”. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e rrëzoi padinë me arsytimin se për zgjidhjen e mosmarrëveshjes zbatohet Kodi i Punës dhe jo ligji nr. 152/2013, për shkak se kërkuesi nuk e gëzonte statusin e nëpunësit civil. Gjykata Administrative e Apelit, mbi ankimin e kërkuesit, vendosi ndryshimin e vendimit, duke pranuar pjesërisht kërkesëpadinë dhe duke detyruar palën e paditur t'i paguajë kërkuesit 1 muaj pagë si dëmshpërblim për mosrespektimin e afatit të njoftimit dhe 2 muaj pagë për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar. Kundër këtij vendimi ushtruan rekurs të dyja palët. Gjykata e Lartë vendosi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me arsytimin se gjykata e apelit ka kapërcyer kufijtë e padisë, duke u shprehur tej kërtimeve të ngritura nga kërkuesi.

Vlerësimi i Gjykatës

E drejta e aksesit e lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor – Sipas Gjykatës së Lartë gjykata e apelit nuk mund të ndryshonte kryesisht objektin dhe shkakun e padisë, e drejtë kjo ekskluzive e Kërkuesit, i cili ka kërkuar zgjidhjen e pasojave në zbatim të ligjit nr. 152/2013 dhe jo të Kodit të Punës. Sipas Gjykatës së Lartë, ndonëse përgatitja, gjykimi dhe zgjidhja e çështjes nuk mund të bazohen vetëm mbi atë që formalisht shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë e që emërtohen “objekti i padisë” dhe “baza ligjore” e saj, përsëri gjykata ka detyrimin të shprehet vetëm për atë që kërkohet nga kërkuesi.

Duke qenë se pika kryesore e pretendimit kushtetues të kërkuesit ka të bëjë me mënyrën se si Gjykata e Lartë ka interpretuar konceptet ligjore procedurale të objektit dhe shkakut ligjor të padisë, të bazës ligjore të padisë dhe të së drejtës së gjykatës së zakonshme për të bërë me nismën e saj cilësimin ligjor të mosmarrëveshjes që i paraqitet për shqyrtim, të rregulluara nga nenet 5, 31, 154 e 185 të KPC-së dhe vendimi unifikues nr. 3/2012, ajo ka vepruar brenda funksionit të saj kushtetues për interpretimin e ligjit, duke i dhënë përgjigje të argumentuar kërkuesit për pretendimet e tij të parashtruara në rekurs, në respektim të së drejtës së aksesit në gjykatë. Arsyetimi i vendimit nuk rezulton i pamjaftueshëm, pasi nuk përmban kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë dhe as të meta të tilla serioze që të cenojnë standardin kushtetues të vendimit gjyqësor të arsyetuar.

Vendimarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, rrëzimin e kërkesës (dy gjyqtarë u shprehën me mendim kundër).

Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë brenda afatit të arsyeshëm - E drejta e pronës – Standardi i arsyetimit të vendimit – E drejta e informimit

FJALË KYÇE

Regjistrimi i aktit të fitimit të pronësisë/ vendim gjyqësor i formës së prerë/ shërbim përmbartimor gjyqësor privat/ tejzgjatje e procedurës së ekzekutimit të vendimit

Mosrespektimi i një vendimi gjyqësor nga organi shtetëror të cilit i drejtohet, përbën shkelje të vetë thelbit të procesit të drejtë dhe të parimit të shtetit të së drejtës. Organi shtetëror nuk mund të refuzojë ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë mbi pretendime rreth diskutueshmërisë së vendimit nga pikëpamja e së drejtës.

Laert Kola (mosekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm) – vendimi nr. 39, datë 14.05.2024

Faktet

Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave i njohu J. K. pronësinë mbi një truall, si dhe kompensoi fizikisht trashëgimtarët e tij ligjorë. Vendimi u regjistrua në ish-zyrën e hipotekës Fier. Kërkuesi, njëri prej trashëgimtarëve, kërkoi të reregjistrojë pronën në regjistrat e pasurive të paluajtshme, kërkesë që u refuzua me arsyetimin se prona ishte regjistruar më parë në emër të Komunës Qendër, Fier. Kërkuesi iu drejtua gjykatës. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë e rrëzoi padinë, vendim ndaj të cilit kërkuesi paraqiti ankim. Meqenëse Gjykata Administrative e Apelit nuk e shqyrtoi çështjen për më shumë se 4 vjet, kërkuesi iu drejtua Gjykatës së Lartë për shkelje të afatit të arsyeshëm, kërkesë e cila u rrëzua. Mbi bazën e kërkesës së kërkuesit Gjykata Kushtetuese vendosi të urdhërojë gjykatën e apelit të gjykojë çështjen e kërkuesit brenda gjashtë muajve. Gjykata e apelit, pas gjykimit të çështjes së themelit, ndryshoi vendimin e Gjykatës së Vlorës dhe pranoi padinë, duke urdhëruar subjektet e interesuara të regjistrojnë pronën. Vendimi nuk u ekzekutua as me ndërhyrjen e përmbartuesit privat.

Në këto kushte, kërkuesi iu drejtua Gjykatës së Vlorës për shkelje të afatit të arsyeshëm, kërkesë e cila u rrëzua me arsyetimin se nuk ishte përmbushur afati njëvjeçar për ekzekutimin e një vendimi të formës së prerë, sipas nenit 399/1 të KPC. Kërkuesi iu drejtua sërish Gjykatës Kushtetuese për cenimin e së drejtës për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë.

Vlerësimi i Gjykatës

Kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive - Edhe pse kërkuesi i është drejtuar gjykatës kompetente përpara plotësimit të afatit të përgjithshëm njëvjeçar të përcaktuar nga neni 399/2, pika 1, shkronja “c”, i KPC-së, kjo kërkesë është në vijim të një procesi gjyqësor për të cilin atij tashmë i është njohur nga Gjykata Kushtetuese shkelja e afatit të arsyeshëm dhe urdhëruar përsheptimi i procedurës së gjykimit të themelit të çështjes. Përmes mjeteve juridike të mbrojtjes që KPC-ja ka ofruar kërkuesi ka kërkuar që të mbrohet edhe në procedurën e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë të dhënë në atë proces gjyqësor.

E drejta për ekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm - Në lidhje me sjelljen e kërkuesit, ai, në cilësinë e kreditorit, ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij dhe ka përmbushur në kohë çdo detyrim procedural. Edhe përmbartuesi gjyqësor privat, si subjekt procedural në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë, pavarësisht mosndërmarrjes së veprimeve shtrënguese të paralajmëruara, ka realizuar hapat e nevojshëm proceduralë për ekzekutimin në kohë të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, mosekzekutimi i vendimit gjyqësor në këtë rast nuk rezulton të vijë për shkak të ndonjë paqartësie të vendimit, që do të bënte objektivisht të pamundur regjistrimin e pasurisë sipas urdhërimit të tij. Sjellja e autoriteteve shtetërore nuk ka qenë në nivelin e duhur të efikasitetit, duke çuar në zvarritje të pajustificuar të ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

Në lidhje me rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi, ndonëse çështja nuk ka të bëjë me ndonjë të drejtë ngushtësisht vetjake, ajo është e lidhur me ushtrimin e së drejtës së pronës, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës. Nisur nga veprimet dhe mosveprimet e organeve shtetërore në moszbatimin e vendimit gjyqësor, por dhe të faktit se është konstatuar edhe më parë cenimi i afatit të arsyeshëm gjatë procesit në gjykatat e zakonshme, çështja është e një natyre të tillë që interesi i kërkuesit rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e tepruar e procedurës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e kërkesës, konstatimin e cenimit të së drejtës dhe urdhërimin e debitorit të përfundojë ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Liria personale - Standardi i arsytimit të vendimit

FJALË KYÇE

*Arrest në burg/ gjendje
shëndetësore veçanërisht e
rëndë/ ekspertizë mjekësore/
Institucioni i Veçantë i
Kujdesit Shëndetësor të të
Burgosurve/ Institucioni i
Ekzekutimit të Vendimeve
Penale (IEVP)*

Nëse do të zbatohet një masë më e butë sigurimi, është e nevojshme të analizohen tre kritere të përcaktuara nga GJEDNJ: (i) kushtet mjekësore të të burgosurit; (ii) përshtatshmëria e ndihmës dhe përkujdesjes mjekësore, në kushtet spitalore të burgut; (iii) përshtatshmëria e masës së sigurimit në përputhje me gjendjen shëndetësore të personit.

Kolegji Penal ka arsyetuar vazhdimin e masës së sigurimit të arrestit në burg duke analizuar këto kritere dhe duke u dhënë përgjigje pretendimeve thelbësore të kërkuesit.

Lifter Koka (*Zëvendësimi i masës së sigurimit personal për shkak të gjendjes shëndetësore*) – vendimi nr. 40, datë 14.05.2024

Faktet

Ndaj kërkuesit janë filluar dy procedime penale, për të cilat është marrë masa e sigurimit “Arrest në burg”. Kërkuesi iu drejtua GJKKO së Shkallës së Parë me dy kërkesa të veçanta për të kërkuar zëvendësimin e masave të sigurimit me një masë më të lehtë për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore. Kërkesat e tij nuk u pranuan dhe kërkuesi ushtroi ankim në GJKKO-në e Apelit, e cila nuk i pranoi ankimet. Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekurseve në të dyja rastet vendime që u kundërshtuan nga kërkuesi duke pretenduar trajtim degradues, cenimin e lirisë personale të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, të së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për mbrojtje efektive dhe të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar e ligj.

Vlerësimi i Gjykatës

Liria personale e lidhur me standardin e arsytimit të vendimit - Gjykata vlerësoi se për të përcaktuar nëse do të zbatohet një masë më e butë sigurimi, duhen analizuar tre kriteret e përcaktuar nga GJEDNJ: (i) kushtet mjekësore të të burgosurit; (ii) përshtatshmëria e ndihmës dhe përkujdesjes mjekësore, në kushtet spitalore të burgut; (iii) përshtatshmëria e masës së sigurimit në përputhje me gjendjen shëndetësore të kërkuesit.

Duke pasur në vëmendje këto kritere, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar vazhdimin e masës së sigurimit të arrestit në burg, duke konsideruar kushtet mjekësore të kërkuesit (kriteri i parë), që pavarësisht vlerësimit të mjekëve është konkluduar se mund të kurohet në mjediset e paraburgimit, pra nuk është provuar pamundësia e mjekimit dhe e ndjekjes së terapive mjekuese si në institucionin mjekësor kur trajtohen të paraburgosurit, ashtu edhe në një institucion të specializuar mjekësor, duke u përshtatur ndihma dhe përkujdesja mjekësore ndaj tij (kriteri i dytë) dhe se verifikimi i vazhdimësisë së masës së sigurimit të arrestit në burg është në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore (kriteri i tretë). Ajo ka analizuar nëpërmjet një interpretimi sistematik, bazuar në kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 81/2020 dhe dispozitat e KPP-së, përmes të cilave u ka dhënë përgjigje pretendimeve thelbësore të kërkuesit për cenimin e lirisë personale dhe mosplotësimin e kritereve për zëvendësimin e masës së sigurimit të arrestit në burg me një masë më të lehtë.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, rrëzimin e kërkesës (katër gjyqtarë u shprehën me mendim kundër).

E drejta e aksesit substancial - Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor

FJALË KYÇE

Shitblerje kuotash/ e drejtë parablerjeje/ truall në përdorim të objektit shtetëror të privatizuar/ mosnjoftim rekursi/ njoftim me shpallje/ memo drejtuar Gjykatës së Lartë

Kërkuesja nuk është njoftuar për rekursin e palëve të paditura, duke u vënë në pamundësi objektive jo vetëm për të marrë dijeni për procesin në Gjykatën e Lartë, por edhe për të ushtruar të drejtën për të paraqitur kundërrekurs, parashtrime, pretendime në mbrojtje të interesave të saj ligjorë e kushtetues. Mungesa e njoftimit të rekursit nuk është riparuar nga Gjykata e Lartë, e cila nuk ka marrë në konsideratë dhe nuk ka shqyrtuar parashtrimet dhe argumentet e sjella nga kërkuesja nëpërmjet memos, e cila mbetet i vetmi mjet i mundshëm procedural për t'u përdorur prej saj.

Gjykatat e faktit arritën në përfundime të kundërta lidhur me faktin nëse kërkuesja kishte ose jo të drejtë të privatizonte truallin në konflikt. Gjykata e Lartë, e ndodhur përpara dy zgjidhjeve diametralisht të kundërta, nuk ka treguar me qartësi përse ka zgjedhur të konfirmojë qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë në raport me atë të gjykatës së apelit, edhe pse nuk ka evidentuar asnjë gabim ligjor në çmuarjen e provave nga kjo e fundit.

Shoqëria “Ferlut” sh.a. (mosnjoftimi i rekursit i palës tjetër në gjykim) – vendimi nr. 41, datë 29.05.2024

Faktet

Kërkuesja, nëpërmjet privatizimit të kuotave, u bë pronare e objektit ish Shkolla e Ushqimit Social në Laprakë (“objekti”), me sipërfaqe truall 4788.5 m². Për një pjesë të këtij truall, me sipërfaqe 3176 m² (“truall”), kërkuesja është në konflikt me shoqërinë AL.P.IN, në pronësi të së cilës është regjistruar kjo pasuri. AL.P.IN u bë ortak e vetme e shoqërisë TTC sh.p.k., pas i bleu kuotat e shoqërisë italiane “GGIF Investment” s.r.l. në TTC, e cila ishte ortak themeluese e TTC bashkë me shtetin shqiptar i cili zotëronte 45% të kuotave. Kuotat e shtetit u privatizuan nga GGIF Investment s.r.l.

Kërkuesja i kërkoi Agjencisë së Kombëtare të Privatizimit shitjen e truallit në përdorim të objektit, por u njoftua se procedura për shitjen e truallit nuk mund të vijonte. AL.P.IN bëri padi kundër kërkueses me objekt lirim dhe dorëzimin e truallit, padi nga e cila më pas hoqi dorë. Gjykata vendosi pushimin e çështjes për këtë pjesë, ndërsa vijoi me shqyrtimin e kundërpadsisë së kërkueses, duke e konsideruar atë si padi. Kërkuesja pretendoi se truallit nuk ka qenë asnjëherë pjesë e kapitalit të TTC dhe se kontratat, duke qenë të lidhura me truallin, janë absolutisht të pavlefshme. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e rrëzoi padinë. Sipas saj kërkueses i mungon legjitimiteti për të kërkuar privatizimin e truallit dhe po ashtu vlerësoi se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me kontratë shitblerjeje truall, por me kontratë shitblerjeje kuotash.

Gjykata e apelit e ndryshoi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar pjesërisht padinë kurse Gjykata e Lartë vendosi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kërkuesja iu drejtua Gjykatës Kushtetuese (Gjykata).

Vlerësimi i Gjykatës

E drejta e aksesit substancial - Kërkuesja nuk është njoftuar për rekursin e palëve të paditura, duke u vënë në kështu në pamundësi objektive jo vetëm për të marrë dijeni për vënien në lëvizje të procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, por edhe për të ushtruar të drejtat e saj që i garantohen nga neni 42. Edhe pse Gjykata e Lartë ka detyrimin të verifikojë nëse administrata gjyqësore ka marrë masat për të kryer njoftimin e rekursit palëve ndërgjyqësore, ajo nuk e ka kryer këtë verifikim. Gjykata e Lartë nuk ka evidentuar në vendim as pretendimet e parashtruara në memot e kërkueses dhe as nuk i ka marrë në shqyrtim ato, duke mos u dhënë përgjigje përfundimtare dhe të arsytuar atyre. Këto mangësi në njoftimin e rekursit, në vlerësimin e Gjykatës, përbëjnë shkelje thelbësore të procesi të rregullt, pasi ndikojnë në të drejtën e aksesit të kërkueses, në të drejtën për t'u drejtuar Gjykatës së Lartë dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare në lidhje me pretendimet e saj, për rrjedhojë edhe në të drejtën për t'u dëgjuar në atë gjykatë në respektim të parimit të barazisë së armëve.

Standardi i arsytimit të vendimit - Gjykatat e faktit arritën në përfundime të kundërta lidhur me faktin nëse kërkuesja kishte ose jo të drejtë të privatizonte truallin. Gjykata e Lartë, e ndodhur përpara dy zgjidhjeve diametralisht të kundërta, nuk ka treguar qartë përse ka zgjedhur të konfirmojë qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë në raport me atë të gjykatës së apelit, edhe pse nuk ka evidentuar asnjë gabim ligjor në çmuarjen e provave nga kjo e fundit.

Po ashtu, vendimi i Gjykatës së Lartë përmban pasaktësi të dukshme në arsytim. Ndonëse rezultoi qartë se kërkuesja kishte kërkuar gjyqësisht të drejtën e privatizimit të truallit, Gjykata e Lartë e mohon shprehimisht këtë në arsytimin e saj. Edhe nëse një rrethanë e tillë do të ishte e vërtetë, kjo, referuar praktikës unifikuese të Gjykatës së Lartë, nuk mund të çonte në rrëzimin e padsisë, por në pushimin e gjyqimit. Prandaj vendimi i Gjykatës së Lartë në këtë drejtim paraqitet kontradiktore dhe arsytimi i tij nuk është në koherencë me dispozitivin, i cili ka vendosur rrëzimin e padsisë, duke cenuar unitetin e pjesëve të vendimit.

Vendimarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e kërkesës.

E drejta e jetës

FJALË KYÇE

Familjar i viktimës së veprës penale/ pezullimi i hetimeve/ parashkrimi i ndjekjes penale/ veprime hetimore të paplota/

E drejta e jetës, në aspektin procedural, kërkon kryerjen e hetimeve efektive nga organi i ndjekjes penale për zbulimin e rrethanave të ngjarjes dhe autorit të saj, të cilat duhet të jenë, ndër të tjera, të plota, të paanshme dhe të kujdesshme.

Prokuroria nuk ka qenë e kujdesshme në kryerjen e një hetimi të plotë, të shpejtë dhe të gjithanshëm, në mënyrë që të siguronte zbatimin efektiv të ligjit për të siguruar mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të jetës.

Lumturi Varfi (cenimi i së drejtës të jetës për shkak të moskryerjes së hetimeve të plota dhe efektive) – vendimi nr. 42, datë 29.05.2024

Fakte

Kërkuesja është motra e shtetasit A.V. (viktima), për të cilin Prokuroria Vlorë regjistroi procedimin penal për veprën penale “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit”. Pasi viktima u gjet më vonë pa jetë, kjo veprë penale u bashkua me atë të “Vrasje me dashje” dhe çështja i kaloi Prokurorisë Fier. Pasi u kryen disa veprime hetimore ato u ndërpre. Mbi ankimin e babait të viktimës zëvendësprokurori i përgjithshëm urdhëroi Prokurorinë Fier të kryente një sërë veprimesh hetimore të tjera. Pasi u kryen edhe disa veprime hetimore deri kur autori i dyshuar rezultoi i vdekur në vitin 1997 Prokuroria Fier pushoi procedimin penal në ngarkim të autorit të dyshuar, ndërsa vendosi pezullimin e hetimeve për zbulimin e personave të tjerë të pidentifikuar. Hetimet mbetën në këtë gjendje deri në shtator 2017, kur ato rifilluan dhe Prokuroria Fier, bazuar në nenet 329/a dhe 328/a(1)(d) të KPP-së, i kërkoi gjykatës të pushonte çështjen, pasi nga çasti i kryerjes së veprës penale kishin kaluar më shumë se 20 vjet, për pasojë ndjekja penale ishte parashkruar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier e rrëzoi kërkesën dhe urdhëroi kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve. Ky vendim u ndryshua nga Gjykata e Apelit, që pranoi kërkesën e prokurorit dhe urdhëroi pushimin e çështjes, pasi afati maksimal 20 vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale ishte plotësuar, përpara ndryshimeve të bëra me ligjin 36/2017. Mbi rekursin e kërkueses, Gjykata e Lartë vendosi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit. Kërkuesja iu drejtua Gjykatës Kushtetuese (Gjykata).

Vlerësimi i Gjykatës

E drejta e jetës - Për shkak të mangësive të veprimeve hetimore në kuptim të përshtatshmërisë, shpejtësisë dhe kujdesit të nevojshëm, autorët e veprës penale mundën t'i shmangeshin drejtësisë. Mosidentifikimi dhe mosmarrja në kohë e të gjitha provave të nevojshme për zbardhjen e ngjarjes, ka çuar në kufizimin më pas të mundësive për zbulimin e plotë të rrethanave të ngjarjes dhe të autorëve të saj. Ndonëse prokuroria dispononte disa të dhëna rreth personave të mundshëm të përfshirë në krim dhe për motivet e tij, ajo nuk rezultoi të ketë ndjekur një linjë të qartë hetimi. Nëse veprimet hetimore do të kishin qenë të shpejta, të plota dhe të orientuara drejt, nisur nga kjo gjasë, rezultati i hetimit do të kishte qenë i ndryshëm, duke shmangur në këtë mënyrë situatën e pandëshkueshmërisë së autorëve të atyre ngjarjeve kriminale. Prokuroria nuk ka qenë e kujdesshme në kryerjen e një hetimi të plotë, të shpejtë dhe të gjithanshëm, në mënyrë që të siguronte zbatimin efektiv të ligjit për të siguruar mbrojtjen e së drejtës së jetës. Pezullimi i hetimit për zbulimin e autorëve për një periudhë të gjatë kohore (20 vjet) nuk ka ofruar asnjë përgjigje efektive në këtë drejtim.

Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve lidhur me efektivitetin e hetimeve në këtë proces penal, por janë mjaftuar me konstatimin e faktit të parashkrimit. Duke vepruar në këtë mënyrë, ato nuk kanë respektuar parimin e subsidiaritetit, pra nuk kanë përmbushur funksionin kushtetues për të garantuar dhe mbrojtur të drejtën themelore të jetës.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e pjesës së kërkesës, duke konstatuar cenimin e së drejtës kushtetuese të jetës për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore për kryerjen e hetimeve të plota dhe efektive.

E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

FJALË KYÇE

Ankim ndaj vendimit për mosfillimin e procedimit penal/ kërkesë për dëmshpërblim/ ngarkesa e sistemit gjyqësor/ reforma në drejtësi/

Gjykata e apelit është në pamundësi objektive për të gjykuar çështjen e kërkesit brenda afatit të arsyeshëm.

Në lidhje me rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi, ai nuk ka argumentuar dhe provuar rrezikun për interesat e tij, natyra dhe rëndësia e të cilëve të justifikojë trajtimin me përparësi dhe shpejtësi të veçantë të çështjes së tij.

Bardhyl Ibra (kohëzgjatja e paarsyeshme e procesit gjyqësor në gjykatën e apelit) – vendimi nr. 43, datë 04.06.2024

Faktet

Kërkuesi ka bërë kallëzim penal ndaj punonjësve të ZVRPP Durrës për të cilin prokurori vendosi mosfillimin e procedimit penal. Mbi bazën e ankimit të kërkuetit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës vendosi pranimin e kërkesës dhe urdhëroi prokurorinë të bënte arsyetimin e plotë të vendimit të mosfillimit. Kërkuesi paraqiti padi kundër Ministrisë së Drejtësisë dhe asaj të Financave dhe Ekonomisë, duke kërkuar detyrimin e tyre ta dëmshpërblejnë në shumën 100,000 lekë, për shkak të veprimeve të parregullta të prokurorisë lidhur me mosarsyetimin e vendimit të mosfillimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës vendosi pranimin e padisë dhe, mbi ankimin e të paditurve, çështja u regjistrua në Gjykatën e Apelit Durrës. Për shkak se ajo nuk ishte shqyrtuar ende kërkuesi iu drejtua Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të procesit të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të ankimit në gjykatën e apelit brenda afatit të arsyeshëm, për të cilën Gjykata e Lartë vendosi rrëzimin.

Vlerësimi i Gjykatës

Shqyrtimi i çështjes brenda një afati të arsyeshëm – Në lidhje me sjelljen e kërkuetit nuk rezultoi që ai të jetë bërë shkak për kohëzgjatjen e procesit. Për sa i takon kompleksitetit të çështjes, ajo nuk paraqitet komplekse. Lidhur me sjelljen e autoriteteve, duke mbajtur parasysh situatën aktuale të ngarkesës së sistemit gjyqësor për shkak të reformës në drejtësi, gjykata e apelit është në pamundësi objektive për të gjykuar çështjen e kërkuetit brenda afatit të arsyeshëm për shkak të volumit të lartë dhe radhës së çështjeve të tjera më të vjetra, me të njëjtën shkallë ose më të lartë përparësi, në pritje për t'u gjykuar.

Në lidhje me rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi, Gjykata vlerëson se çështja e kërkuetit, për shkak të natyrës që ka, nuk lidhet me interesa "vetjakë e jetësorë" duke qenë se pretendimet kanë të bëjnë me veprimet e parregullta të Prokurorisë Durrës, të cilat janë gjetur të drejta me vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës që ka urdhëruar Prokurorinë Durrës të kryejë arsyetimin e plotë të vendimit të mosfillimit të çështjes penale, duke korrigjuar edhe gabimet materiale të këtij vendimi.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, rrëzimin e kërkesës (katër gjyqtarë u shprehën me mendim kundër).

E drejta e aksesit substancial – Standardi i arsytimit të vendimit

FJALË KYÇE

Kthim prone/ regjistrim vendim KKKP-je ose VKM-je/ çregjistrim i titullit të pronësisë/ shterimi i mjeteve juridike efektive/ afat i arsyeshëm/

Gjykatat e zakonshme kanë analizuar dhe vlerësuar pretendimet e kërkuarve dhe u kanë dhënë përgjigje të arsyetuar atyre, duke garantuar të drejtën e aksesit substancial.

Eleonora Poga, Gjergji Shalësi, Petrika Shalësi, Sofiana Shakaj, Rozi Beqiri, Zaira Poga (vlerësimi i veprimeve të ZVRPP-së për çregjistrimin e titullit të pronësisë në bazë të VKM-së) - vendimi nr. 44, datë 04.06.2024

Faktet

KKKP-ja Tiranë u ktheu kërkuarve një sipërfaqe truall, pjesë e të cilit ndodhej brenda aneksit të Stadiumit “Selman Stërmasi”, Tiranë. Vendimi u regjistrua në regjistrat e kohës së hipotekës. Me VKM-në nr. 342/2005 u miratua lista e inventarit të pasurive të Stadiumit ku përfshihej edhe kjo sipërfaqe trualli dhe mbi bazën e kërkesës së Bashkisë së Tiranës, ZVRPP-ja Tiranë e regjistroi truallin në pronësi të saj. Kërkesës së kërkuarve për regjistrimin e truallit sipas vendimit të KKKP-së, ZVRPP-ja iu përgjigj se ai ishte regjistruar në pronësi të Bashkisë. Kërkuarve iu drejtuan ZVRPP-së për fshirjen e regjistrimit, kërkesë që u refuzua me arsyetimin se fshirja e regjistrimit ishte jashtë juridiksionit të ZVRPP-së. Kërkuarve paraqitën padi, e cila u rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me arsyetimin, veç të tjerash, se përpara se të kërkonin fshirjen e regjistrimit, kërkuarve duhej të kundërshtonin në gjykatë aktin administrativ. Gjykata Administrative e Apelit e la në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, kurse Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekursit.

Vlerësimi i Gjykatës

Kriteri i shterimit të mjeteve juridike – VKM-ja nr. 342/2005 e kundërshtuar në objekt të kërkesës nuk rezulton të ketë qenë objekt i gjykimeve të kundërshtuara por është kundërshtuar për herë të parë në ankimin kushtetues individual.

E drejta e aksesit substancial e lidhur me standardin e arsytimit të vendimit - Kërkuarve kanë kërkuar zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje të natyrës administrative, në themel të së cilës ishte ligjshmëria e veprimeve të ZVRPP-së për të cilat gjykatat e faktit kanë vlerësuar se janë bërë në përputhje me ligjin dhe regjistrimi i truallit në pronësi të Bashkisë është bërë mbi bazën e VKM nr. 342/2005, akt administrativ të cilin kërkuarve nuk e kanë kundërshtuar në gjykatë, gjë që e bën të pamundur shqyrtimin e vlefshmërisë së këtij akti sipas objektit të mosmarrëveshjes. Gjykata konstaton se gjykatat kanë analizuar dhe vlerësuar pretendimet e ngritura nga kërkuarve, duke u dhënë përgjigje të arsyetuar atyre dhe duke garantuar kështu të drejtën e aksesit substancial të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

Vendimarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, rrëzimin e kërkesës (katër gjyqtarë u shprehën me mendim kundër).

E drejta për proces të rregullt – Efektiviteti i mjetit kompensues

FJALË KYÇE

Përshpejtim i gjykimit/kompensim/ shpërblim dëmi/ afati i arsyeshëm

Kur Gjykata shqyrton pretendimet për tejzgjatjen e mjetit juridik riparues/ korigjues, individit nuk mund t`i kërkohet që edhe gjatë këtij procesi të përdorë apo të shterojë mjetet juridike që parashikojnë nenet 399/1 e vijues të KPC-së. Një qëndrim i ndryshëm do të bënte këto mjete të humbnin qëllimin e tyre dhe do t`i vinin individit një barrë të tepruar, pasi do e detyronin atë të vinte në lëvizje procese gjyqësore për të siguruar shpejtësinë dhe efektivitetin e një mjeti që në vetvete ka për qëllim përshpejtimin dhe parandalimin e shkeljes së kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor.

Padia për kompensim për dëmin e shkaktuar nga tejzgjatja e gjykimit duhet të shqyrtohet brenda një afati të arsyeshëm dhe këto procedura duhet të kryhen në mënyrë të menjëhershme, në mënyrë që zgjidhja të mbetet efektive.

Laert Kola (mungesa e efektivitetit të mjetit kompensues)- vendimi nr. 45, datë 11.06.2024

Faktet

Kërkuesi vuri në lëvizje një proces gjyqësor për pavlefshmërinë e aktit administrativ me anë të të cilit ZRPP-ja kishte bërë regjistrimin e një sipërfaqe truall në emër të Komunës Qendër, Fier dhe regjistrimin e vendimit të KKKP-së që ia ka njohur atë trashëgimlënësit të kërkuesit. Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë e rrëzoi kërkesëpadinë dhe mbi ankimin e kërkuesit çështja u regjistrua në Gjykatën Administrative të Apelit. Duke qenë se ajo nuk ishte shqyrtuar ende kërkuesi iu drejtua Gjykatës së Lartë për përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit për këtë shkak, e cila u rrëzua. Gjykata , e vënë në lëvizje nga kërkuesi, vendosi pranimin e kërkesës dhe konstatimin e cenimit të së drejtës për shkak të mosgjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në vijim kërkuesi iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi për shpërblimin e dëmit si rezultat i konstatimit të cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm në Gjykatën e Apelit, padi që u pranua pjesërisht prej saj. Vendimi u ankimua nga të dyja palët dhe çështja u regjistrua në gjykatën e apelit. Kërkuesi paraqiti kërkesë për përshpejtimin e gjykimit të çështjes dhe më pas kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të shqyrtimit të ankimit, e cila u rrëzua nga Gjykata e Lartë me arsyetimin se sipas nenit 399/2 KPC, afati i zakonshëm i gjykimit në apel është dy vjet dhe veçantia e çështjes nuk është reflektuar nga ligjvënësi me parashikimin e afateve ligjore të posaçme në gjykimin në apel.

Vlerësimi i Gjykatës

Kriterit racione personae - Kërkuesi, edhe pse ka një vendim të gjykatës së shkallës së parë që ia ka njohur të drejtën e shpërblimit për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor të shqyrtimit të padisë së themelit, që përbën një masë të favorshme ndaj tij, jo vetëm që nuk ka mundur ta ekzekutojë vendimin, por është ende në pritje të shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit, e vënë në lëvizje mbi bazën e ankimit të tij. Në këto kushte, kërkuesi nuk e ka humbur statusin e viktimës, në drejtim të përshtatshmërisë dhe efektivitetit të mjetit kompensues.

Kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive - Edhe pse kërkuesi, formalisht, ka paraqitur në gjykatat e zakonshme kërkesë për konstatimin e vonesës në shqyrtimin e çështjes së tij civile, një rrethanë e tillë nuk është e rëndësishme në drejtim të legjitimitetit të tij në aspektin kushtetues, pasi ky lloj gjykimi nuk kërkon shterimin e mjeteve juridike.

Konstatimi i shkeljes së të drejtës për proces të rregullt për shkak të mungesës së efektivitetit të mjetit kompensues - Neni 399/7 i KPC-së ka përcaktuar afatin 3-mujor për gjykimin e padisë për shpërblimin e dëmit nga depozitimi i saj. Edhe pse kjo dispozitë shprehet për shqyrtimin e padisë dhe nuk i referohet shqyrtimit të ankimit, qasja e ofruar nga Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Apelit në interpretimin e kësaj dispozite nuk përputhet me përmbajtjen dhe qëllimin e dispozitave që kanë rregulluar mjetet mbrojtëse korigjuese/kompensuese, të cilat kanë synuar jo vetëm riparimin e shkeljes të së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm, por edhe sigurimin e gjykimit në një kohë sa më të shpejtë. Gjykata rithekson se gjykimi i këtyre lloj çështjesh, përfshirë edhe në gjykatën e apelit, duhet të jetë i shpejtë dhe ai nuk mund t`u nënshtrohet afateve të përgjithshme të gjykimit. Ky ka qenë edhe synimi i ligjvënësit kur në nenet 399/1 e vijues të KPC-së ka parashikuar afate të posaçme, të shkurtra, për shqyrtimin e mjeteve mbrojtëse të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Në veçanti, neni 399/7, pika 1, i KPC-së ka parashikuar një afat të posaçëm 3 mujor për gjykimin e mjetit kompensues në shkallë të parë, afat ky që meriton të mbahet parasysh edhe për gjykimin në apel.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e kërkesës.

Parimi i mosrëndimit të pozitës së të gjykuarit (reformatio in peius) – E drejta e ankimit

FJALË KYÇE

Prodhim i armëve luftarake/ Mbjajtja pa leje e armëve luftarake/ pengmarrje/ rrëmbim i personit/ gjykim i shkurtuar/ cilësim juridik i fakteve

Cilësimi juridik i veprës penale është pjesë e konceptit kushtetues të dënimit penal, pasi ai ndikon drejtpërdrejt në individualizimin e veprës penale, si dhe përcakton llojin dhe kufijtë e dënimit. Kur gjykata e apelit vihet në lëvizje vetëm mbi ankimin e individit, ajo nuk mund të ushtrojë diskrecion për të ndryshuar cilësimin juridik të veprës, duke rënduar pozitën e individit.

Zbatimi i nenit 425, pika 3, të KPP-së nuk lidhet vetëm me masën e dënimit të dhënë nga gjykata, por edhe me cilësimin juridik të veprës.

Francesk Vala (ndryshimi i cilësimit juridik të faktit penal kur gjykata vihet në lëvizje vetëm në bazë të ankimit të të pandehurit (neni 425 i KPP-së))- vendimi nr. 46, datë 11.06.2024

Faktet

Kërkuesi është proceduar penalisht për kryerjen e veprave penale “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit”. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, që ka gjykuar çështjen sipas rritit të gjykimit të shkurtuar, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale të parashikuar në nenet 109, paragrafi i parë, e 25 të KP-së dhe dënimin e tij me 11 vjet burgim, si dhe deklarinimin fajtor për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit” dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim. Në bashkim të dënimeve, kërkuesi është dënuar me 12 vjet burgim dhe në zbatim të nenit 406 të KPP-së është dënuar përfundimisht me 8 vjet burgim. Vendimi u ankimua nga kërkuesi dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda vendosi të ndryshojë vendimin e shkallës së parë duke deklarinimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 109, paragrafi i tretë dhe 25 të KP-së dhe dënimin e tij me 11 vjet burgim, ndërkohë që ka lënë në fuqi vendimin e ankimuar për veprën penale të parashikuar nga neni 278, paragrafi i parë, i KP-së. Bazuar në nenin 55 të KP-së dhe nenin 406 të KPP-së, kërkuesi është dënuar përfundimisht atë me 8 vjet burgim. Gjykata e Lartë, pasi shqyrtoi rekursin e kërkuesit, vendosi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit.

Vlerësimi i Gjykatës

Parimi i mosrëndimit të pozitës së të gjykuarit (reformatio in peius) të lidhur me të drejtën e ankimit - Vepra penale për të cilën kërkuesi është akuzuar dhe gjykuar parashikohet në paragrafin e parë të nenit 109 të KP-së, që përmban një dënim me burgim nga 10 deri 20 vjet kurse paragrafi i tretë i kësaj dispozite përmban një dënim me burgim jo më pak se 20 vjet. Për rrjedhojë, cilësimi juridik i veprës penale sipas paragrafit të tretë të nenit 109 të KP-së është më i rëndë se ai sipas paragrafit të parë.

Në kohën e dhënies së vendimit të apelit, neni 425 i KPP-së ishte i pandryshuar dhe gjykata e apelit e ka interpretuar literalisht atë në rastin e kërkuesit, pa analizuar frymën e parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit në procesin penal. Ky vendim është dhënë nga gjykata e apelit në datën 21.07.2017, në momentin kur ndryshimet ligjore (përfshirë nenin 425) ishin miratuar në datën 30.3.2017, ishin publikuar në Fletore Zyrtare në datën 5.5.2017 dhe hyrja në fuqi ishte çështje ditësh.

Sipas Gjykatës, interpretimi i Gjykatës së Lartë se ndryshimi i cilësimit juridik nuk ka ndryshuar masën e dënimit të dhënë për kërkuesin, është një interpretim i ngushtë që ajo i ka bërë përmbajtjes së nenit 425, pika 3, të KPP-së, duke cenuar jo vetëm thelbin e parimit *reformatio in peius*, por edhe thelbin e së drejtës së ankimit të të pandehurit në një gjykatë më të lartë. Edhe pse gjykata e apelit nuk ka ndryshuar masën e dënimit për kërkuesin, kjo nuk ka asnjë rëndësi në rastin konkret për sa kohë që zbatimi i nenit 425, pika 3, të KPP-së nuk lidhet vetëm me masën e dënimit të dhënë nga gjykata, por edhe me cilësimin juridik të veprës sipas parashikimeve të nenit 109 të KP-së.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin e kërkesës.

Parimi i sigurisë juridike – Parimi i barazisë përpara ligjit

FJALË KYÇE

Zgjidhje e kontratës së punës/ afati i njoftimit/ e drejt e rikthimit në punë/ vendim unifikues/ pritshmëri të ligjshme

Kur ka një vendim unifikues ose njësesues të Gjykatës së Lartë në drejtim të zbatimit të ligjit material ose procedural për një çështje të caktuar, ky fakt sjell pritshmëri për individin se ligji do të zbatohet dhe interpretohet në mënyrë uniforme, siç është njësuar me vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë për të njëjtën çështje ligjore.

Arlinda Mulgeci (interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë në këndvështrim të vendimit unifikues)- vendimi nr. 47, datë 11.06.2024

Faktet

Drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD) ka vendosur zgjidhjen e marrëdhënies së punës midis kërkueses dhe DPD-së. Kërkuësja paraqiti padi për anulimin e vendimit të zgjidhjes së kontratës së punës, dëmshpërblimin për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës, si dhe kthimin në vendin e mëparshëm të punës. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e rrëzoi padinë, referuar edhe vendimeve unifikuese nr. 7/2011 dhe nr. 8/2007 të Gjykatës së Lartë. Ky vendim u ndryshua nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila vendosi pranimin e pjeshëm të padisë, duke detyruar DPD-në t'i paguajë kërkueses 12 paga mujore. Mbi rekursin e DPD-së, Gjykata e Lartë vendosi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke arsyetuar se DPD-ja ka respektuar kërkesat e neneve 143, 144 dhe 145 të Kodit të Punës ndaj kontrata konsiderohet e zgjidhur normalisht.

Vlerësimi i Gjykatës

Parimi i sigurisë juridike i lidhur me parimin e barazisë përpara ligjit - Nisur nga fakti se devijimet nga praktikata gjyqësore apo vendimet njësesuese mund të passjellin cenim të sigurisë juridike si dhe të vënë në dyshim trajtimin e barabartë të individëve, Gjykata analizon përmbajtjen e vendimit unifikues nr. 19/2007 në drejtim të pritshmërive të kërkueses për zgjidhje të çështjes së saj në përputhje me të. Gjykata konstatoi se interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë se, me pagesën e 3 muajve pagë për efekt të afatit të njoftimit, DPD-ja ka respektuar detyrimin e saj për të njoftuar paditësen dhe kontrata e punës konsiderohet e zgjidhur normalisht, nuk është në të njëjtën linjë me qëndrimin e vendimit unifikues nr. 19/2007. Gjykata e Lartë e ka marrë këtë rast për në shqyrtim dhe ka dhënë vendim për të, ndonëse çështja ligjore që lidhet edhe me këtë rast ishte shtruar për njësim pak kohë përpara se sa vendimi të kundërshtohet në Gjykatë të Lartë. Duke mos analizuar çështjen konform vendimit unifikues Gjykata e Lartë ka cenuar pritshmëritë e ligjshme të kërkueses për zbatimin e ligjit në harmoni me praktikën gjyqësore të kësaj gjykate.

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin e kërkesës (katër gjyqtarë u shprehën me mendim kundër).

E drejta e jetës

FJALË KYÇE

Vetëvrasje/ marrja e masave nga punonjësit e sigurisë të aeroportit/ veprime ose mosveprime në kundërshtim me detyrën/ hetime efektive/ pushimi i procedimit penal

Dhënia me koncesion e menaxhimit të shërbimeve publike palëve të treta nuk shmang detyrimet pozitive të shtetit në kuadër të nenit 21 të Kushtetutës dhe nenit 2 të KEDNJ-së. Aeroporti përbën një zonë ku organet ligjzbatuese ushtrojnë mbikëqyrje të veçantë në drejtim të ruajtjes së rendit dhe sigurisë.

Në rastin konkret nuk evidentohet se punonjësit e sigurisë së aeroportit mund të parashikojnë qëllimet e viktimës, as edhe të përcaktojnë si pasojë rrezikun real e të menjëhershëm që mund t'i shkaktohej jetës së viktimës. Sapo ky rrezik është bërë evident ata kanë marrë masa për të parandaluar ardhjen e pasojës, si dhe për dërgimin e viktimës me urgjencë në spital.

Shaban Kapllanaj (e drejta e jetës në aspektin substancial dhe procedural) – vendimi nr. 49, datë 20.06.2024

Faktet

Një person rreth 25 vjeç është ngjitur në zyrat e aeroportit Rinas dhe më pas është hedhur nga lartësia. Pavarësisht ndihmës mjekësore ai ka ndërruar jetë. Mbi bazën e materialeve të referuara nga punonjësit e sigurisë së aeroportit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (prokuroria) regjistroi procedimin penal për veprën penale “Shkaktimi i vetëvrasjes” dhe pas hetimeve vendosi pushimin e tij, për shkak të mosplotësisë të elementeve të figurës së veprës penale. Babai i viktimës (kërkuesi) e kundërshtoi vendimin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila vendosi rrëzimin e kërkesës. Pasi shqyrtoi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Tiranë vendosi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së Tiranës. Kërkuesi iu drejtua Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke parashtruar se i është cenuar: (i) e drejta e jetës, e garantuar nga neni 21 i Kushtetutës, pasi punonjësit e sigurisë së aeroportit nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për parandalimin e ngjarjes ndërkohë që prokuroria nuk ka kryer hetime efektive për zbardhjen rrethanave të saj dhe se ka hetuar për veprën “Shkaktimi i vetëvrasjes”, dhe jo atë “Shpërdorimi i detyrës”; (ii) e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës në drejtim të së drejtës së aksesit, pasi nuk është njoftuar për datën e shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit, dhe standardit të arsytimit, pasi gjykatat nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tij.

Vlerësimi i Gjykatës

E drejta e jetës në aspektin substancial – Gjykata vëren se aeroporti “Nënë Tereza” përbën një zonë ku organet ligjzbatuese (punonjësit e sigurisë private të aeroportit, sipas marrëveshjes së koncesionit) ushtrojnë mbikëqyrje të veçantë në drejtim të ruajtjes së rendit dhe sigurisë, çka kërkon përmbushjen nga shteti të detyrimeve pozitive në kuadër të nenit 21 të Kushtetutës dhe nenit 2 të KEDNJ-së. Në analizë të vendimeve të gjykatave, Gjykata vlerëson se autoritetet ligjzbatuese kanë marrë masa për garantimin e aspektit substancial të së drejtës së jetës së djalit të kërkuesit. Në rastin konkret nuk evidentohet se punonjësit e sigurisë së aeroportit mund të parashikojnë qëllimet e viktimës, as edhe të përcaktojnë, si pasojë, rrezikun real e të menjëhershëm që mund t'i shkaktohej jetës së viktimës. Sapo ky rrezik është bërë evident, punonjësit e sigurisë së aeroportit kanë marrë masa për të parandaluar ardhjen e pasojës, si dhe për dërgimin e viktimës me urgjencë në spital. Në këtë këndvështrim, nga ana e këtyre punonjësve nuk rezultojnë të jenë kryer veprime ose mosveprime në kundërshtim me detyrimet që neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së vendosin në lidhje me situatat kur një individ kërcënon të vetëvritet në sy ose në prani të tyre dhe nuk rezultojnë që ata të kenë shfaqur neglizhencë në drejtim të garantimit të së drejtës së viktimës për jetën. Po kështu, Gjykata çmon se gjykatat e zakonshme kanë argumentuar mjaftueshëm qëndrimet e mbajtura në vendimet e tyre në kuadër të aspektit substancial të së drejtës së jetës.

E drejta e jetës në aspektin procedural - Prokuroria vendosi për pushimin e procedimit, për shkak se nuk ka rezultuar që persona konkretë, me veprime ose mosveprime, me dashje indirekte ose nga pakujdesia, të kenë shkaktuar ose lejuar, në kundërshtim me detyrën, ardhjen e pasojës. Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesit në këtë drejtim janë marrë në shqyrtim nga gjykatat e zakonshme, të cilat i kanë analizuar ato përkundëjt veprimeve të ndërmarra nga prokuroria, duke dhënë përgjigje të arsyetuar për qëndrimet e mbajtura prej tyre. Në lidhje me pretendimet për njoftimin, në kushtet kur ankimi ndaj vendimit të gjykatës së rrethit është ushtruar nga kërkuesi, në të cilin ka parashtruar pretendimet e tij, si dhe nuk rezultojnë të jenë paraqitur prapësime në lidhje me të nga prokuroria, Gjykata çmon se moskryerja e njoftimit me shpallje për datën e gjykimit në gjykatën e apelit nuk e ka vënë kërkuesin në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat e tij ose në kushte të pabarabarta ndaj prokurorisë.

Vendim marrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, rrëzimin e kërkesës

(tre gjyqtarë u shprehën me mendim kundër dhe një gjyqtar me mendim paralel).

Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor

FJALË KYÇE

Kontratë sipërmarrjeje/detyrime që rrjedhin nga kontrata/legalizim i ndërtimit pa leje/ e drejtë e pronës/ mosnjohim i rekursit dhe i datës së seancës gjyqësore

Është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, në mënyrë të veçantë, të arsyetimit të vendimit. Gjykata ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë.

Anastas Risto (interpretimi i dispozitave të KC -së dhe të ligjit të zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes civile) - vendimi nr. 50, datë 20.06.2024

Faktet

Kërkuesi dhe subjekti i interesuar (sipërmarrësi) kanë lidhur një kontratë sipërmarrjeje në vitin 1999, për një apartament me sipërfaqe 134 m², pjesë e një pallati 8-katësh, ndërtimi i të cilit do të fillonte në shtator të 1999 dhe do të përfundonte në prill të 2001. Paga e kontratës do të bëhej e ndarë në katër këste. Sipërmarrësi e ndërtoi pallatin pa marrë leje nga organet kompetente dhe ndërtimi përfundoi në vitin 2004, vit në të cilin kërkuesi filloi ta përdorë atë. Kërkuesi nuk e shleu këstin e fundit dhe ai gjithashtu kishte zënë një sipërfaqe 42 m² (garazh) jashtë kushteve kontraktuale, të cilin ia dha me qira një personi të tretë. Sipërmarrësi bëri padi me objekt shlyerjen e detyrimeve që rridhnin nga kontrata e sipërmarrjes dhe lirim in e sipërfaqes 20 m² të zënë jashtë kushteve kontraktuale, si dhe detyrimin për të kthyer vlerat e përfituara pa të drejtë, si dhe lirim in e mjedisit prej 42 m². Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi pranimin e pjeshëm të kërkesëpadsisë, duke detyruar kërkuesin të lironte sipërfaqen 42 m², si dhe të kthente shumën 1,200,000 lekë të përfutur në mënyrë të padrejtë nga dhënia me qira e garazhit. Gjykata e Apelit vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Tiranës për pjesën e rrëzimit të padsisë dhe ndryshimin e vendimit për pjesën tjetër, duke vendosur rrëzimin e padsisë për kërkimin e lirim in të sipërfaqes 42 m², si dhe pagimin e frytëve civile nga përdorimi i sendit. Mbi rekursin e paditësit Gjykata e Lartë vendosi prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Tiranës.

Vlerësimi i Gjykatës

Cenimi i parimit të sigurisë juridike të lidhur me parimin e barazisë përpara ligjit.

Gjykata vlerëson se, në thelb, pretendimi i kërkuesit ka të bëjë me interpretimin e dispozitave të KC-së dhe të ligjit nr. 9482/2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje". Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë, brenda kompetencave kushtetuese të saj si gjykatë ligji, ka interpretuar ligjin dhe interpretimi konkret nuk rezultoi të jetë haptazi i paarsyeshëm ose që të bjerë ndesh me konceptin e gjykimit të drejtë. Konkretisht, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se paditësi është ndërtues i të gjithë godinës, në të cilën banon edhe kërkuesi dhe ka detyrimin ligjor që të përgatisë dokumentacionin ligjor edhe për këtë mjedis ndihmës në pallat. Ndërtimi ka qenë pa leje dhe është bërë nga paditësi me investimin e tij dhe në bazë të nenit 32/a të KC-së ka interes të ligjshëm, pasi në cilësinë e investitorit i është drejtuar ALUIZNI-it për të legalizuar ndërtimin e pallatit. Gjykata e Lartë ka parashtruar se kërkuesi ka lidhur kontratë sipërmarrjeje me paditësin, duke e njohur atë si ndërtuesin e pallatit dhe fakti që ndërtimi ka qenë pa leje nuk mund të legjitimojë të kërkuesin të shfrytëzojë dhe të nxjerrë të ardhura nga sipërfaqe ndërtimi që nuk i takojnë. Gjykata konstatoi se Gjykata e Lartë kishte arsyetuar se përderisa objekti është në proces legalizimi dhe objekti gëzon pritshmëri të ligjshme për t'u ligjëruar si ndërtim, për rrjedhojë, paditësi, si investitor i ndërtimit pa leje legjitimohet të marrë në dorëzim pasurinë në përputhje me ligjin nr. 9482/2006 dhe se kërkuesi ka qenë posedues me keqbesim.

Vendimarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, rrëzimin e kërkesës (një gjyqtar u shpreh me mendim kundër).

E drejta e aksesit - Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor

FJALË KYÇE

Njohje pronar/ pronë e fituar me trashëgimi/ padi rivendikimi/ posedues i paligjshëm/ vendime diametralisht të kundërta/ vendim unifikues/ e drejta e pronës

Ndërsa gjykata e shkallës së parë e ka shqyrtuar dhe zgjidhur konfliktin si një mosmarrëveshje me natyrë civile, gjykata e apelit e ka shqyrtuar mosmarrëveshjen, në thelb, si të natyrës administrative.

Gjykata e Lartë ndodhej përpara dy vendimeve të gjykatave më të ulëta që kanë mbajtur qëndrime të ndryshme në drejtim të mënyrës se si e kanë përcaktuar mosmarrëveshjen mes palëve, gjë që i impononte të ushtronte rolin e saj si gjykatë ligji duke verifikuar mënyrën e zbatimit të ligjit dhe vendimeve të saj unifikuese.

Lulzim Jajaga (vendime gjyqësore diametralisht të kundërta në drejtim të përcaktimit të mosmarrëveshjes) – vendimi nr. 51, datë 20.06.2024

Faktet

Kërkuesi është një nga trashëgimtarët e ish-pronarit, të cilëve KKKP-ja e Bashkisë Tiranë i ka kthyer një truall prej 11,181 m², një pjesë e të cilit është regjistruar në pronësi të kërkuesit. Kërkuesi ka paraqitur padi rivendikimi kundër subjekteve të interesuara, duke pretenduar se janë posedues të paligjshëm dhe ka kërkuar lirim dhe dorëzimin e truallit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi pranimin e padisë kurse Gjykata e Apelit Tiranë vendosi ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë, me arsytimin se kërkuesi nuk duhej të ngrinte padi rivendikimi, por padi për kundërshtimin e vendimeve të KKKP-së së Këshillit të Rrethit Tiranë, mbi bazën e të cilave subjektet e interesuara e posedonin pronën në mënyrë të ligjshme. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vendosi mospranimin e rekursit të kërkuesit.

Vlerësimi i Gjykatës

E drejta e aksesit substancial e lidhur me standardin e arsytimit të vendimit - Procesi gjyqësor është vënë në lëvizje nga kërkuesi nëpërmjet një padie rivendikimi, sipas nenit 296 të KC-së, si padia kryesore për mbrojtjen e pronësisë, me anë të së cilës pronari kërkon kthimin e sendit të vet nga personi që e mban atë pa shkak juridik. Gjykata e shkallës së parë e ka shqyrtuar dhe zgjidhur konfliktin si një mosmarrëveshje me natyrë civile, duke analizuar nëse plotësoheshin kushtet e padisë së rivendikimit, kurse gjykata e apelit ka arsytuar se kërkuesi nuk duhet të ngrinte padinë e kërkimit të sendit, por të kundërshtonte vendimet e KKKP-së së Këshillit.

Gjykata e Lartë ndodhej përpara dy vendimeve të gjykatave më të ulëta që kanë mbajtur qëndrime të ndryshme në drejtim të mënyrës se si e kanë përcaktuar mosmarrëveshjen mes palëve, gjë që i impononte të ushtronte rolin e saj si gjykatë ligji duke verifikuar mënyrën e zbatimit të ligjit dhe vendimeve të saj unifikuese.

Ndonëse në rekurs janë ngritur pretendime për parregullsi në procesin gjyqësor, sikurse është edhe e drejta e pronës private, Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje këtyre pretendimeve me natyrë kushtetuese duke mos ushtruar rolin e saj kushtetues. Mospranimi i rekursit të kërkuesit nga Gjykata e Lartë, duke u mjaftuar vetëm me parashtrimin në vendim të shkaqeve të rekursit dhe me arsytimin *de plano* se këto shkaqe nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa u dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve me natyrë kushtetuese, të çon në përfundimin se zbatimi i ligjit procedural nga ajo është haptazi i paarsyeshëm

Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin pjesërisht të kërkesës.